

HOME

POLITIKË

AKTUALITET

EKONOMIA

BOTA

RAJONI

OPINIONE

INTERVISTA

GOSSIP

TECH

KULTURA

SPORT

DOSSIER

LIFESTYLE

Simpoziumi i UMT, mënyra si lehtësohet punësimi i të rinjve



Punësimi është sfida më e madhe e të rinjve, sidomos të atyre që janë në përfundim, apo sapo kanë përfunduar studimet e larta. Por, shpesh, arsyeja pse një punë vonon, nuk ka të bëjë me arsye objektive, por ka të bëjë me mospërgatitjen e studentëve për të aplikuar ashtu siç duhet aty ku duhet për një vend pune. Kjo ka qenë arsyeja se përse Universiteti Metropolitan Tirana, një universitet që ka në qendër të tij degët inxhinierike dhe ekonomike, zhvilloi një simpozium me pjesëmarrje të pedagogëve dhe personaliteteve, për të këshilluar të sapodiplomuarit dhe studentët mbi rrugëtimin e tyre

drejt punësimit. Dok. Fatmira Kola, shefe e Departamentit të Ekonomisë në UMT, njëherazi edhe organizatore e këtij evenimenti thotë në një intervistë për gazetën, se tregu është i vështirë ngado, jo vetëm në Shqipëri, por kjo nuk do të thotë se rrugët mungojnë për realizimin e suksesit.

- UMT zhvilloi ditët e fundit një simpozium në lidhje me punësimin e të rinjve. Cilat ishin pritshmëritë dhe rezultatet e këtij simpoziumi?

Objektivi i këtij simpoziumi kishte si qëllim fokusimin e problematikave të punësimit veçanërisht tek të rinjtë. Duke ditur se Universiteti Metropolitan Tirana kërkon zhvillimin dhe pasurimin kulturor të burimeve njerëzore dhe përgatitjen e tyre në përputhje me kërkesat e tregut të punës, shpesh herë ne mundohemi të analizojmë cilat janë tendencat e tregut të punës dhe ti përshtasim ato sa më mirë në mësimdhënie. Së pari falenderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe shpresoj që ky simpozium mos të jetë i vetmi. Zhvillimi akademik dhe kulturor i të rinjve duhet të përshtatet më së miri me pritshmëritë e tyre në të ardhmen. Në këtë simpozium u diskutuan

problematika të ndryshme që karakterizojnë tregun e punësimit, ku disa prej tyre janë edhe sfidat që në Universitetin Metropolitan kërkojmë të realizojmë. Suksesi i një Universiteti nuk matet nga numri i të diplomuarve që ka çdo vit, por nga performanca e tyre reale dhe sa e gjejnë veten në tregun e punës. Universiteti Metropolitan investon shumë në përgatitjen e brezave të rinj. Pedagogët e angazhuar në mësimdhënie kanë titullin Prof. Doktor ose janë Lektorë të rinj që kanë mbaruar Universitetin në Perëndim me rezultate maksimale.

- Sipas gjykimit tuaj, cilat janë sfidat kryesore në punësimin e studentëve dhe të sapodiplomuarve?

Të rinjtë dalin nga bankat shkollore ku njohin pak realitetin dhe kulturën e punës edhe pse janë të përgatitur shumë mirë në nivel teorik, nga ana tjetër kompanitë shqiptare kërkojnë të punësojnë persona me eksperiencë dhe shpesh herë nuk marrin në konsideratë potencialet e të rinjve. Këtu ka një përballje, e cila sjell pasoja negative tek të rinjtë. Mendimi im është që këtë sfidë duhet ta ndajë Universiteti me kompanitë private. Duhet më shumë bashkëpunim për interesa të përbashkëta.

- Në bazë të rezultateve të simpoziumit, ku duhet të përqendrohen studentët dhe të sapodiplomuarit për të hyrë në tregun e punës?

Gjatë simpoziumit u la të kuptohet që një person mund të gjejë punë nëse ka referenca të mira, një background të mirë kulturor dhe normalisht nëse është produktiv në punë. Kërkohej shumë fleksibilitet si në pozicionin e punës, ashtu edhe në orare. Ashtu si dhe u diskutua gjatë këtij simpoziumi studentët duhet ta marrin Universitetin shumë seriozisht dhe serioziteti fillon që nga frekuentimi i leksioneve, angazhimi në seminare dhe detyra kurse, sepse sot nuk gjen punë nëse e konsideron shkollën për të marrë një copë letër të quajtur "Diplomë". Studentët duhet të kenë besim tek vetvetja, të kenë vullnet, ta shfrytëzojnë kohën sa më mirë duke investuar tek vetvetja. Para se të aplikojnë për një vend pune duhet të jenë të vendosur se çfarë duan të bëjnë në jetë.

- Në kuadër të kësaj tematike, a mendoni se edhe universitetet duhet të krijojnë mundësi për punësimin e studentëve dhe a e ofron diçka të tillë UMT?

Siç folam edhe më lart, Universiteti Metropolitan investon shumë në burimet njerëzore. I jep mundësinë të gjithë atyre personave që kanë dëshirën, vullnetin dhe seriozitetin për të punuar. Universiteti Metropolitan ka partneritet me shumë institucione publike dhe private ku ka mundësuar dhe internshipe për studentët si në Banka dhe firma ndërtimi, po ashtu ka dhe disa studentë që punojnë në administratën e Universitetit. Mendoj që Universitetet duhet të jenë të parët që të hedhin hapin drejt bashkëpunimit për punësimin e studentëve të

tyre, pasi kjo rrit edhe besimin nga ana e studentëve në këto institucione. Kjo është një nismë që nuk mendoj se do ngeli me kaq. Do mundohemi që strategjitë e universitetit të fokusohen më shumë në këtë aspekt. Gjithashtu përfitoj nga rasti tu bëj thirrje kompanive private se janë gjithmonë të mirëpritura në simpoziume të ardhshme për të diskutuar së bashku.

- Çfarë udhëzoni për studentët, maturanët dhe të sapodiplomuarit në lidhje me sfidën e punësimit?

Sot tregu i punës është i vështirë, jo vetëm në Shqipëri por edhe në vende të zhvilluara. Të gjesh një punë të mirë me pagesë të mirë duhet të kesh aftësi të veçanta që të bësh diferencën, por edhe njohuri të gjuhëve të huaja. Maturanëve do ju këshilloja që kur të zgjedhin se çfarë të studiojnë, duhet të mendojnë dhe mundësitë e punësimit që mund të kenë në të ardhmen pa harruar dhe prirjet që ata kanë. Universiteti është një investim. Jo pa qëllim ne jemi fokusuar kryesisht te Inxhinieria e Ndërtimit, Inxhinieria Kompjuterike dhe Fakulteti Ekonomik, pasi këto janë dhe profesionet më të kërkuara në treg. Të sapodiplomuarit do ti udhëzoja të jenë të motivuar kur aplikojnë për një pozicion pune, si fillim të mos fokusohen te pagesa por te rritja profesionale që mund ti ofrojë ajo kompani, sepse e rëndësishme nuk është vetëm ta gjesh punën por edhe të dish ta mbash. Sot është e vështirë të gjesh një punë ku të punosh i vetëm, për këtë është shume i rëndësishëm bashkëpunimi në grup. Duhet tolerancë, vullnet dhe seriozitet që punëdhënësi ta vlerësojë e të ketë ai nevojën për ty, e jo ti për të.

Thursday, January 23, 2014 - 08:25

Vlerësoni lajmin

Total votes: 26



GOOGLEPLUS




g+1

0



Rreth botës me një telefonatë...
Me paketat e reja ndërkombëtare
300 Lekë dhe 500 Lekë.




METALSINES BALKAN
www.metalsines-balkan.com
blv. Zhan D'Ark, Rruga Sitki Çiço No. 6
1000 Tirana, Albania
e-mail: albania@metalsines-balkan.com
tel. +355 42 238 2019
**Design, manufacturing and maintenance
of freight wagons.**



NEWSLETTER

RREGJISTROHUNI ME EMAIL DHE MERRNI CDO DITË LAJMET E FUNDIT NGA GAZETA SOT!

E-mail *




RREGJISTROHU

GOSSIP

MOTRAT BREGU NË KONCERTIN E ANASTACIAS ME VAJZAT E TYRE

Majlina dhe Ornela Bregu së bashku me vajzat e tyre po ndjekin nga afër koncertin e Anastacias. Ky koncert po zhvillohet në Tiranë në stadiumin "Qemal Stafa". Motrat Bregu dhe vajzat e tyre bukuroshe, të veshura sportive e kanë...



LEXO MË SHUMË →

ÇILJETA SUPER NË FORMË NË PLAZH (FOTO-LAJM)

RONA NISHLIU FESTON DITËLINDJEN, RAMA I DHURON NJË BUQETË ME LULE

WOW NJË MREKULLI! JLO NJË BOHEMIANE E VËRTETË (FOTO-LAJM)

LEXONI TË GJITHA LAJMET NGA GOSSIP

SPORT

BALOTELI EMOCIONON MILANIN: U KTHEVA TEK EKIPI I ZEMRËS

Kampionati italian do të ketë në gjirin e tij këtë edicion një nga sulmuesit e spikatur të viteve të fundit në rang evropian, Mario Balotelin, i cili u rikthye në gjirin e skuadrës së tij, Milanit. Pas një eksperience të dështuar në Premier League...

LEXO MË SHUMË →



PORTUGALIA ME PROBLEME, TJETËR SHANS PËR SHQIPËRINË TË ARRIJË FITOREN

SKËNDERBEU TURPËROHET NË ZAGREB, E MUND DINAMO ME 10 VETË

PËRFUNDON AVENTURA E SKËNDERBEUT NË CHAMPIONS, ELIMINOHET NGA DINAMO E ZAGREBIT ME REZULTAT 4-1

LEXONI TË GJITHA LAJMET NGA SPORTI

DOSSIER

GAZETA AFRIKANE: JA KUR U NGRIT FLAMURI SHQIPTAR PËR HERË TË PARË PAS PERIUdhËS SË SKËNDERBEUT

Një fakt interesant është zbuluar për vendin tonë nga shkrimtari Adam Robert. Ky i fundit ka mundur të gjejë në një bibliotekë britanike një raportim sa i përket një ngjarje të rëndësishme për vendin tonë. Gazeta e Afrikës së...

LEXO MË SHUMË →



ABDURRAHMAN ROZA HAXHIU, LEGJENDA E SPORTIT SHQIPTARË (FOTO-LAJM)

SHQIPJA E NGRIRË NË KOHË! MATERIALE 300 VJEÇARE NË GJUHËN ARBËRESHE (FOTO-LAJM)

FOTO TË RRALLA! SHQIPËRIA NË LUFTËN E PARË BOTËRORE (FOTO-LAJM)

LEXONI TË GJITHA LAJMET NGA DOSSIER

Na Ndiqni Në Facebook




Gazeta SOT
11.656 "Mi piace"

Mi piace questa Pagina

Condividi

Di' che ti piace prima di tutti i tuoi amici



Ndalohet rreptësisht prodhimi i faqes ose i një pjese të saj pa kërkuar një leje të shkruar, nëse jo, kjo është një shkelje e të drejtave.

Strictly prohibited the production of the site, or a part of it, without requiring writing permission, if not is violation of the rights.

Copyright 2000 - 2014 www.sot.com.al

Albania Web Design & Development by: WWW.FIT.AL

